

ABU SEMAN
NR. Prot-460
Dat 23/05/2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr 18. Datë 11/05/2017

Për
miratimin e kërkesës, për leje përdorimi të burimit ujore të perroit Panaritit dege e lumit Osum,
për prodhim hidroenergjie në bashkia Korce Qarku Korce.

Në mbështetje të ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar të burimeve ujore" neni 5, neni 12 pika 1, neni 13 pika 2 d, neni 50 pika 2. Vendimit Nr 416 date 13.05.2015 Keshillit të Ministrave "Per miratimin e kushteve të përgjithshme e të posacme, dekontave shoqeruse, afatit të vlefshmerise, formularve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore". Vendimit të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 5 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per organizimin dhe funksionimin e Keshillit të Basenit Ujore si dhe Vendimi të Keshillit Kombëtar të Ujit Nr 6 date 16.02.2016 "Per miratimin e rregullores "Per funksionimin e Agjencise së Basenit Ujore" Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

Miratimin e kërkesës, për leje përdorim të burimit ujore të perroit Panaritit dege e lumit Osum,
për prodhim hidroenergjie në bashkia Korce Qarku Korce.

HEC Vile

Vepra e marrjes

Kordinatat e vepres së marrjes janë :

X = 44 54 711.1436; Y = 44 81 625.0727 Z = 786 m.n.d

- Prurja mesatare do të jete $Q_{mes} = 0.822 m^3/s$
- Prurja llogaritese do të jete $Q_{llog} = 1.20 m^3/s$
- Prurja ekologjike do të jete $Q_{eko} = 0.123 m^3/s$

Goda e hec-it

Kordinatat e godines së HEC janë :

X= 44 54 338.6635; Y= 44 79 220.0727 Z= 582 m.n.d

- Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritetet të jete 1998 kW.

Përdorimi i burimit ujqor të përdoret pa cenuar interesat e përdoruesve:

- Te mos cenoj furnizimin me uje te popullates dhe te industrise per nevojat e tanishme dhe te prespektives.
- Te zbatoj grafikun per vaditje ne kohe (dite) dhe ne sasi (l/s) per cdo vite te hartuara nga Bordet e Kullimit te pushtetit vendore dhe ate Qendrore.
- Te respektoj grafikun e vaditjes edhe jashte periudhes kur e kerkon Bordi i Kullimit .
- Te respektoj rrjedhjen ekologjike.
- Si dhe te plotesoj kushtet e percaktuara nga institucionet qendrore dhe lokale.

Ngarkohet AUB Seman për zbatimin e këtij vendimi.

PËRGJEGJËSI AUB SEMAN



**NENKRYETARI I KBU
SEMANTIA
Gentian Nushi**

